



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____prot

Peshkopi, më: _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: ERALD-G *me adrese:* Diber Peshkopi Herbel, Ndertesa private Nr.61.

Procedura e prokurimit/lotit: **Sherbim Konsulence.**

Numri i procedurës: REF-89251-11-30-2023 Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Objekti: Shërbim projekt zbatimi për rruget e brendshme dhe rurale, shkollave, kopshteve në Bashkinë Diber për vitin 2023, me fond limit: 14.535.997,5 (Katërmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e nentëqind e nentëdhjetë e shtatë presje pesë) leke pa TVSH dhe kohëzgjatja e kontratës është 4 muaj.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

- 1.ERALD-G, me nr. Nipti :K36306784K
- 2.INSTITUTI DEKLIADA-ALB, me nr. Nipti : K71606006A
3. NET-GROUP, me nr. Nipti : L72023002P
4. BOE: SEED CONSULTING me nipt: L41824014Q &&& SON Engineering & Construction me nipt:L51424014F.

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. ERALD-G, me nr. Nipti :K36306784K
Vlera 14.450.000 (Katërmbëdhjetë milion e kateriqind e pesëdhjetë mijë) leke pa tvsh, me pike të marra 98.6 (Nentëdhjetë e tetëpresje gjashtë)

2. INSTITUTI DEKLIADA-ALB, me nr. Nipti : K71606006A

Vlera 14.535.000 (Katermbedhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë) leke pa TVSH me pike të marra 95.42 (Nentëdhjetë e pesë presje dyzete e dy).

Lista e operatorëve ekonomikë të skualifikuar:

1- BOE: SEED CONSULTING me nipt: L41824014Q &&& SON Engineering & Construction me nipt:L51424014F

Per arsyje si mëposhte:

Referuar parashimeve në nenin 21 të LPP, autoriteti kontraktor është përgjegjës për procesin e prokurimit në përputhje me parashikimet ligjore e nenligjore në fuqi. Pra, zhvillimi dhe finalizimi i procedurave të prokurimit, përfshirë këtu edhe procesi i vlerësimit është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, konkretisht e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim "KVO", referuar parashikimeve të nenit 75 të VKM Nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar (në vijim "VKM").

Në çdo rast, referuar parashikimeve ligjore në fuqi, KVO vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit

Ne zbatim të ligjit nr. 162 date 23.12.2020 "Për prokurimin public" I ndryshuar perkatesisht në nenin 83 pika 1 citohet që: "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", dhe në pikën 2 po të ketij neni, Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

Dhe në rastin konkret autoriteti kontraktor Bashkia Diber e ka parashikuar dhe kërkuar si kriter në seksionin numer 3, pika 3.1 të dokumentave standarte të tenderit për këto procedure prokurimi.

Kjo gjë zbatim në V.K.M nr. 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" I ndryshuar, perkatesisht në nenin 30 pika 1 ku citohe që :

"Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar".

Referuar nenin 54//11/b të VKM parashikohet se: "Në fazën e dytë, kërkesa për propozime, që u dërgohet kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër, përfshin:

- i. ftesat, ku deklarohen qëllimi i autoritetit ose entit kontraktor për të nënshkruar kontratën për shërbimet e konsulencës, burimi i fondeve, hollësi të tjera për kandidatin, adresa, data, ora e përcaktuar për dorëzimin e propozimeve;
- ii. udhëzimet për ofertuesit, ku jepet i gjithë informacioni i nevojshëm që do t'i ndihmonte ofertuesit për përgatitjen e propozimeve, si dhe informacione për procesin e vlerësimit, metodologjinë, kriteret e vlerësimit e faktorët e rëndësishëm përkatëse të tyre dhe pikët minimale për cilësinë;
- iii. periudhën e vlefshmërisë së propozimit;
- iv. kushtet e projektkontratës, që do të prokurohet;
- v. afatet kohore për dorëzimin e propozimeve;
- vi. formularin e sigurimit të ofertës sipas përcaktimit në LPP.

Gjate shqyrtimit të dokumentacionit tuaj për procedurën e prokurimit, rezultoi që ju nuk keni dorëzuar në asnjë llojë forme sigurimin e ofertës, që është perkatesisht në vlerën 290.712 (Dyqind e nentëdhjetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) leke, sa 2 % i vlerës së fondit limit dhe për rrjedhojë jeni të skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi.

2. NET-GROUP, me nr. Nipti : L72023002P nuk ka marr pjesë në fazën e dytë të procedurës së prokurimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ERALD-G me adresë: Diber Peshkopi Herbel, Nderresa private Nr.61, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 14.450.000 (Katërmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) leke pa tvsh / totali i pikëve të marra 98.6 (Nentëdhjetë e tetëpresje gjashtë) është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me marrjen/publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Rahim SPAHIU